

FJALA E DEPUTETIT GAZMENT BARDHI

E ENJTE 14 KORRIK 2022

Të dashur bashkëqytetarë,

Reforma në drejtësi ishte dhe mbetet kërkesë e shumicës dërrmuese të qytetarëve shqiptarë, që mendonin e besonin se kjo reformë do t'i jepte fund pandëshkueshmërisë; do të siguronte barazinë para ligjit dhe do t'i hiqte përfundimisht statusin "të paprekshëm" një grushti njerëzish që kontrollojnë qeverisjen dhe ekonominë e vendit me qytetarët më të varfër në Europë. 6 vjet nga miratimi me konsensus i reformës kushtetuese në drejtësi, secili prej jush, që e besonte këtë, duke më përfshirë edhe mua, pyet veten: a ka ndodhur kjo? Dikush në këtë sallë, por edhe jashtë saj mund të thotë që është fillimi, është ende shpejt.

Edhe unë bëj pjesë tek ajo kategori qytetarësh që mendon se institucionet e reja të drejtësisë janë në provë; duhen inkurajuar të bëjnë punën e tyre; duhen mbështetur apo duhen nxitur që të zbatojnë ligjin. Mirëpo, koha kalon dhe shenjat e para janë zhgënjyese. Shumica e institucioneve të reja të drejtësisë janë bërë funksionale më shumë se 3 vjet më parë. Në 3 vjet qytetarët duhet të kishin filluar të merrnin mbrapsht besimin që investuan te reforma në drejtësi, duhet të kishin parë që ata që, deri dje gëzonin statusin "të paprekshëm", të ndjenin frikën e asaj që quhet drejtësia e re. Por, për fat të keq, kjo nuk ka ndodhur. Drejtësia e ka marrë tashmë emrin "e re", por në sjellje vijon të jetë "e vjetër".

Ajo vazhdon të jetë drejtësia që godet në palcë të pamundurin, qytetarin e zakonshëm, dhe u jep imunitet atyre që kanë qenë e vijojnë të jenë të paprekshëm. Për të qenë konkret, këtë do ta ilustroj me një shembull domethënës, që është para syve të secilit prej nesh, përse drejtësia nuk mund të jetë kurrë e re në sjellje nëse është produkt i vullnetit të një Kryeministri të korruptuar. Në 5 vjet, sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, 3 304 qytetarë janë dënuar për veprën penale "ndërtim i paligjshëm". Asnjë prej këtyre 3304 qytetarëve nuk ka bërë ndërtim të paligjshëm as gradaçela dhe as biznese. Përkundrazi, kanë rregulluar çatinë e

shtëpisë së tyre të rrënuar, kanë rregulluar murin rrethues apo kanë rregulluar dhomën e gjumit të fëmijëve të tyre. Pavarësisht se kanë qenë në majë të malit, në zona të thella apo të izoluara, ata nuk i kanë shpëtuar syrit të institucioneve.

Menjëherë u kanë shkuar Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, bashkia, policia, prokuroria dhe në fund ka hyrë në lojë edhe gjykata. duke i dënuar. Mirëpo, fat të ndryshëm për drejtësinë e re kanë “të paprekshmit”. Ata mund të ndërtojnë pa leje ngjitur me zyrën e Kryeministrit, përballë sallës, ku ne ushtrojmë veprimtarinë si deputetë, poshtë dritares së zyrës së kryetarit të Bashkisë së Tiranës, përballë derës së zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, në lagjen ku banon drejtuesi i SPAK-ut apo drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe janë të qetë, sepse e dinë që të gjithë këta do të ulin kokën, kur të kalojnë përpara ndërtimeve pa leje që bëjnë “të paprekshmit”.

Për mua drejtësia nuk është kurrë e re kur i tregon dhëmbët, i tregon ligjin një fshatari që rregullon çatinë e shtëpisë, por ul kokën përpara kateve pa leje të gradaçelave në mes të Tiranës, vetëm për faktin se pas tyre është një i paprekshëm. Kjo nuk është drejtësia e re, por është drejtësi më e vjetruar se drejtësia e vjetër. Kjo nuk është drejtësia ku qytetarët ushqyen besim, kjo nuk është drejtësia që siguron drejtësinë para ligjit. A mund të më thoni kolegë, por edhe Prokurori i Përgjithshëm, meqenëse është prezent, pse është i ndryshëm pronari i kësaj gradaciele në qendër të Tiranës nga 3304 qytetarët e tjerë që kanë shkuar në burg për ndërtime pa leje? Pse ligji nuk është i barabartë për 3304 qytetarët dhe pronarin e këtij ndërtimi?

Besoje keni parë të gjithë se e keni përballë. E di ti, Ulsi, sepse keni miratuar edhe vendim për këtë, por do t’jua shpjegoj unë tani. Përgjigjja është vetëm një se 3304 qytetarët, që janë dënuar për ndërtim pa leje, nuk janë pjesë e oborrit të Kryeministrit, nuk ndajnë para me të, nuk kanë mbrojtjen e Kryeministrit. Nëse je pjesë e oborrit të Edi Ramës, nëse ndan para me të ose me ministrat e tij, nëse ke mbrojtjen e tij drejtësia e re, që është më e vjetruar se vjetra, ul kokën mbyll sytë dhe nuk shikon. Nëse je pjesë e oborrit të Kryeministrit mund të ndërtosh jo një mur ose çati, por plot 5 kate pa leje, në mes të Tiranës, me vlerë tregu 30 milionë euro dhe të gjitha institucionet, përfshirë prokurorinë dhe gjykatat ulin kokën, nuk shikojnë, nuk veprojnë, por janë në garë kush t’i shërbejë më parë për të fshehur ligjin.

Po pse them unë se janë të paprekshëm se kanë mbrojtjen e Edi Ramës dhe Kryeministri është në shërbim të tyre? Që të jem i qartë nuk bëhet fjalë vetëm për këtë ndërtim. Ky është një ndër dhjetëra rasatet e ndërtimeve pa leje ku kanë mbirë kate pa leje në të gjithë Tiranën, por këtë rast e kam të faktuar me dokumente zyrtare. Çfarë tregojnë dokumentet zyrtare që provojnë që jo vetëm që Edi Rama i ka dhënë statusin i paprekshëm, që respekton edhe drejtësia me prapashtesën “e re”, por vendos shtetin në dispozicion për të mbuluar ligjërisht paligjshmërinë. Oligarku, mik i Edi Ramës merr leje ndërtimi për 37 kate mbi tokë dhe 5 kate nën tokë, por ndërkohë ndërton 42 kate mbi tokë dhe 5 kate nën tokë. Pasi i ndërton pa leje ligji nuk vepron. Çfarë bën Edi Rama, thoni ju? Zbaton ligjin? Jo, ndryshon ligjin për interesa të këtij oligarku.

Konkretisht Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në vartësi të Edi Ramës, në vijim të një kërkesë për informacion, të depozituar prej meje me 15 prill të vitit 2022, më informon se për këtë ndërtim, që unë tregova në foto, Edi Rama ka firmosur 2 vendime, të parin për miratimin e lejes së zhvillimit për 37 kate mbi tokë dhe 5 kate nën tokë, dhe të dytin për lejimin e shtimit të disa kateve shtesë. Pasi firmos pa kryer asnjë verifikim dhe pa marrë asnjë konfirmim, nëse është respektuar ose jo leja e parë, ndërkohë që 5 kate shtesë pa leje janë ndërtuar paraprakisht, Edi Rama urdhëron Erion Veliajn të miratojë lejen e ndërtimit për shtesë të disa kateve. Më 13 qershor të vitin 2022, plot 2 muaj pasi unë e kisha vënë zyrtarisht në dijeni kryetarin e bashkisë dhe Kryeministrin dhe kisha kërkuar informacion zyrtar, Erion Veliaj bën sikur nuk kupton, por ndërkohë më informon se nuk e ka miratuar kërkesën për leje ndërtimi për katet shtesë.

Kjo është përgjigjja e kryetarit të bashkisë. Ndërkohë që për faktin se tashmë katet shtesë pa leje janë ndërtuar dhe bërë fakt i kryer, Erion Veliaj, që shet gjithçka dhe ka gjithçka në këtë qytet, më referon të pyes tek Inspektorati Kombëtar i Territorit, sepse sipas tij inspektimi dhe kontrolli i përditshëm i territorit është kompetencë e tyre. Sipas informacionit zyrtar të Bashkisë së Tiranës, refuzimi i lejes së ndërtimit është bërë për arsye se ndryshimi i projektit i propozuar, pra kërkesa për të shtuar disa kate mbi lejen e ndërtimit, të miratuar në vitin 2018, që, në fakt, janë shtyrë pa leje, nuk është në përputhje me nenin 17 të vendimit numër 408, datë 15.05.2015 “ Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit.

E përsëris sipas Bashkisë së Tiranës shtesa e kateve të kërkuara ndalohet nga neni 17 i VKM-së me nr. 408. Çfarë bën Edi Rama? Se mos mendon ndonjë prej jush që zbatoi ligjin apo urdhëroi vartësit që këtë ndërtim ta trajtonin në mënyrë të barabartë me 3304 qytetarë të tjerë që ishin dënuar pse ndërtojnë pa leje çatitë e shtëpive të tyre? Jo, nuk zhgënjën edhe në këtë rast, por e vendos shtetin në shërbim të paligjshmërisë, sepse paligjshmëria është kryer nga oborri i tij. Dhjetë ditë pasi Bashkia e Tiranës refuzon të miratojë lejen e ndërtimit për shtimin e disa kateve, me pretendimin se bie ndesh me nenin 17 të VKM-së, Edi Rama me firmë të Belinda Ballukut dhe të Arben Ahmetajt miraton vendimin nr. 457, datë 29 qershor 2022, të Këshillit të Ministrave dhe ndryshon nenin 17 të VKM-së, që pengonin, në fakt, ligjërimin e një paligjshmërie që na vret sytë të gjithëve, por për fat të keq deri më sot të gjithë kanë ulur kokën.

Pra, kur ndërtojnë qytetarët, zoti prokuror i Përgjithshëm, meqë jeni në seancë, pa leje, ligji vepron dhe ata përfundojnë në burg, por kur ndërtojnë të paprekshmit, oligarkët me të cilët qeveria ndan paratë, Edi Rama ul kokën, policia ul kokën, ju ulni kokën, prokuroria ul kokën dhe ligji nuk vepron. Jo vetëm që askush nuk hyn në burg, por Edi Rama ndryshon vendimin e qeverisë për ta bërë të ligjshëm një ndërtim të paligjshëm, duke i siguruar oligarkut, mik i tij, plot 30 milionë euro fitime vetëm për 5 kate shtesë. A ka rast më të pastër korrupsioni dhe shpërdorim detyre sesa ky? Si mund ta vendosësh shtetin në dispozicion të paligjshmërisë? Si mund t'i ndryshosh ligjet për një rast konkret për të ligjësuar paligjshmërinë? Pse nuk e bën këtë Edi Rama për çatinë e një familjeje në një fshat të Shqipërisë? Përgjigjja është e qartë, 3304 qytetarët nuk janë të barabartë me grushtin e njerëzve që janë pjesë e oborrit të Edi Ramës, sepse 3304 qytetarët nuk janë të barabartë me ndërtuesin e kësaj grataçele dhe as me ndërtuesit e tjerët të grataçelave në Tiranë që kanë të njëjtën problematikë.

3304 qytetarët e dënuar për ndërtim pa leje nuk janë oborri i Edi Ramës dhe i ministrave të tij. Edi Rama e di që për oborrin e tij e ka vënë poshtë vetes drejtësinë me prapashtesën e re, por që është më e vjetruar se drejtësia e vjetër. Edi Rama e di që inspektoratet, bashkia, policia, prokurorët, prokurori i Përgjithshëm, drejtuesi i SPAK-ut do të ulin kokën dhe do të bëjnë sikur nuk e shohin paligjshmërinë në mes të Tiranës, sepse atë e ka kryer dikush që Edi Rama i ka

dhënë statusin “i paprekshëm”. Këtë ju e quani drejtësi e re? I nderuar zoti prokuror i Përgjithshëm, Unë do të doja shumë t’ju shikoja që ta ngrinit kokën kur të dilni nga kjo sallë dhe të kaloni përpara këtij ndërtimi dhe dhjetëra të tjerëve si ky në mes të Tiranës që kanë të njëjtën problematikë. Ngrijeni kokën dhe na tregoni që ligji është i barabartë për të gjithë, bëjeni këtë pa marrë leje nga Edi Rama, bëjeni këtë për Shqipërinë, bëjeni këtë për fëmijët tuaj dhe për mijëra e mijëra familje të ndershme që kanë vendosur t’i rrisin fëmijët në këtë vend!

Bëjeni këtë dhe na tregoni që jeni vërtetë “drejtësia e re”, siç keni filluar me përkëdheli ta quani veten, sepse që u tregoni dhëmbët 3304 qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi, por ul kokën përpara të paprekshmëve të Edi Ramës dhe vetë Edi Ramës, nuk është drejtësi e re, kjo është e njëjta drejtësi e vjetruar, që edhe pse fytyrën mund ta ketë të re, mendjen dhe sjelljen e ka të vjetër, e ka të njëjtë.

Të nderuar kolegë,

Të jemi të vërtetë me bashkëqytetarët tanë, të paktën t’u kursejmë talljen shqiptarëve dhe të mos u themi që drejtësia është e re për 3304 qytetarët e zakonshëm që dënohen pse ndërtojnë pa leje çatinë e shtëpisë së tyre, por është më e vjetruar se drejtësia e vjetër ku ndërton 5 kate në mes të Tiranës pa marrë leje, sepse je oligark i Edi Ramës, je Shefqet Kastrati dhe gëzon statusin “i paprekshëm”. Drejtësia do të jetë e re kur të ketë fytyrën, mendjen dhe sjelljen e re; drejtësia do të jetë e re kur askush të mos guxojë statusin “i paprekshëm”; drejtësia do të jetë e re kur Kryeministri të mos guxojë që ditën për diell të ndërmarrë veprime, ta vendosë shtetin në dispozicion të oborrit të tij për të mbuluar paligjshmërinë; drejtësia do të jetë e re kur Edi Rama të jetë i barabartë me 3304 qytetarët e këtij vendi, kur oligarkët të jenë të barabartë me 3304 qytetarët e këtij vendi, kur ne në këtë sallë të jemi të barabartë me 3304 qytetarët e tjerë të këtij vendi.

Deri sa kjo të ndodhë, ajo që ju me përkëdheli e quani “drejtësi e re”, do të vazhdojë të jetë thjesht drejtësia e re e të paprekshmëve të rinj. Në këtë sallë do të bëjmë sikur u rekomandojmë institucioneve të drejtësisë prioritete dhe institucionet e drejtësisë do të bëjnë sikur po ndërtojnë drejtësinë e re, që po presin prej 6 vjetësh qytetarët shqiptarë. Drejtësia e re e të paprekshmëve nuk rregullohet as me rezoluta dhe as me rekomandime, drejtësia e të

paprekshmëve rregullohet vetëm duke larguar atë që shpërndan sot titujt “i paprekshëm”.
Faleminderit!